Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0593

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 08. 09. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të Operatoreve Ekonomik (OE) "Defence Security" SH.P.K, OE "Security Code", dhe OE "S.I.G" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të kontratës, të Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut" me numër të prokurimit KEK-23-4552-2-1-1, me 16/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "Defence Security" me nr. 2023/0593, e datës 18/08/2023, ankesa e OE "S.I.G" SH.P.K. me nr. 2023/597 e datës 18/08/2023, vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut me numër të prokurimit KEK-23-4552-2-1-1, anulohet, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

2. Aprovohet, tëheqja nga ankesa e OE "Security Code" me nr. 2023/0594, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut me numër të prokurimit KEK-23-4552-2-1-1.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Defence Security" SH.P.K. dhe "S.I.G" SH.P.K.

5. Meqenëse parashtruesi i ankesës OE "Security Code" është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 19.05.2023, Korporata Energjetike e Kosovës SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut" me numër të prokurimit KEK-23-4552-2-1-1.

Me 02. 08. 2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar OE "Internal Security Association" SHPK.

OE "S.I.G" SH.P.K. me datën 06.08.2023, si dhe OE "Defence Security" Sh.P.K, OE "Security Code" me datë 07.08.2023 kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim në AK kundër njoftimit për dhënie kontrate. Me datën 09.08.2023, AK KEK Sh.A me vendim ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim të OE-ve ankues.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, operatorët ekonomik ankues "Defence Security" Sh.P.K, OE "Security Code" si dhe OE "S.I.G". SH.P.K me datën 18.08.2023 kanë parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0593, 2023/0594 dhe 2023/0597, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE "Defence Security" Sh.P.K

- Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka bere vlerësimin, shqyrtimin dhe krahasimin e ofertave konform kërkesave te dosjes se tenderit dhe legjislacionit ne fuqi, duke rekomanduar për dhënie te kontratës OE te përgjegjshëm me çmimin me te lire te ofertës. Sa i përket pikës 7 te dosjes se tenderit "softuerin", ju sqarojmë se ne dosjen e tenderit nuk është kërkuar ndonjë dokument për te dëshmuar përveç deklaratës qe OE do ti përmbush te gjitha pikat dhe OE i rekomanduar për dhënie te kontratës është deklaruar konform kërkesës se dosjes se tenderit. Sa i përket zyrtarit për siguri dhe shëndet ne pune ju sqarojmë se ne web faqen e Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies sociale është e publikuar lista e ekspertëve të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe ne mesin e kësaj liste është edhe zyrtari i paraqitur ne oferta nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE "Security Code" SHPK

- Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka bere vlerësimin, shqyrtimin dhe krahasimin e ofertave konform kërkesave te dosjes se tenderit dhe legjislacionit ne fuqi, duke rekomanduar për dhënie te kontratës OE te përgjegjshëm me çmimin me te lire te ofertës. Ju nuk i keni plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit si më poshtë: Ju nuk keni prezantuar listën e kontratave dhe as referencat. Dëshmi që Menaxheri i Projektit posedon b. Përvojë 3 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik- Mungon dëshmia për përvoja ne fushën e sigurimit fizik. Sigurimi i tenderit është 119 dite e jo 120 dite sipas kërkesës ne DT. Mungon dëshmia e përvojës se punës te mbikëqyrësit: Pika 2.c Se paku 2 vite përvojë në sektorin e shërbimit të sigurimit. Sa

i përket zyrtarit për siguri dhe shëndet ne pune ju sqarojmë se ne ueb faqen e Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies sociale është e publikuar lista e ekspertëve të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe ne mesin e kësaj liste është edhe zyrtari i paraqitur ne oferta nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE "S.I.G" ShPK

- Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka bere vlerësimin, shqyrtimin dhe krahasimin e ofertave konform kërkesave te dosjes se tenderit dhe legjislacionit ne fuqi, duke rekomanduar për dhënie te kontratës OE te përgjegjshëm me çmimin me te lire te ofertës. Keni prezantuar automjetet të cilat nuk janë në pronësi tuaj. Automjetet janë në pronësi të kompanive Rent Mara dhe Rent Elroni me të cilat ju nuk keni marrëveshje direkte për marrjen me qira të automjeteve. Ju në ofertë keni prezantuar një marrëveshje me kompaninë Jaguar Security SH.P.K e cila pastaj ka një marrëveshje për marrjen e automjeteve me qira nga kompanitë Rent Mara dhe Rent Elroni. Në marrëveshjen në mes të Jaguar Security SH.P.K dhe dy kompanive për dhënie me qira të automjeteve ceket se Jaguar Security SH.P.K mund ti shfrytëzoj automjetet për nevojat e saj dhe nuk ceket se mundë ti jap në shfrytëzim kompanive tjera si në rastin në fjalë. Andaj keni dëshmitë se posedoni vetëm dy vetura te dokumentuara për shfrytëzim ne baze te kërkesës ne DT. Sa i përket zyrtarit për siguri dhe shëndet ne pune ju sqarojmë se ne web faqen e Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies sociale është e publikuar lista e ekspertëve të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe ne mesin e kësaj liste është edhe zyrtari i paraqitur ne oferta nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Defence Security" Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi* Duke marr parasysh rëndësinë e objekteve qe duhet te ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për autoritetin kontraktues. Paga minimale bruto bazë (te pagesave shtese dhe lejimeve konform Ligjit të Punës ne fuqi), për roje fizike të angazhuar ne ketë kontratë duhet të jetë jo me pak se 386 € ne muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar qe te respektoj Ligjin e punës dhe Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2017. Ne këtë rast Kontraktori obligohet te paguaj shtese mbi pagën baze për ndërrimin e dyte dhe te trete dhe festa. Kontraktori obligohet te furnizoje edhe një shujtë te ngrohte për çdo ndërrim. Duke iu referuar Ligjit te punës ne fuqi dhe UA te ndërlidhura, fondi orëve për një muaj është 176 për një muaj. Pra ju keni saktësuar se OE duhet ta respektojnë Ligjin e Punës dhe Udhëzimet tjera Administrative për të mbrojtur të drejtat e punëtoreve por në raportin e datës 26.07.2023 ju në këtë rast anëtarët e komisionit kanë bërë më shumë "vlerësim" sipas tekeve të tyre dhe jo sipas kërkesave këtë e themi sepse në faqen nr 17 të këtij raporti ju keni pasqyruar si vijon: Pra këtu shifet qartë se këta anëtar komisioni kanë fshehur duke tentuar të mashtrojnë një pjesë të kërkesave të DT-së dhe të drejtave të punëtoreve ku sipas Ligjit të Punës e drejtë themelore e secilit të punësuar pas marrjes së pagës është pushimi vjetor /zëvendësimi kjo ceket qartë në nenin 32 Pushimi vjetor 1. I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar. Pra vërehet qartë se ky detaj nuk është kalkuluar në këtë "analizë" ku për koiqidencë edhe OE i rekomanduar për kontratë ka paraparë këtë të drejtë të paraparë me Ligj. Po ashtu komisioni nuk ka kalkuluar as festat zyrtare ku janë kërkuar dhe nuk e ka përfshirë sipas kërkesës tuaj. Po ashtu tek vlera e sigurimit shëndetësor ka vendosur

një vlerë të pabazuar por vetëm supozuese vlerë e cila është më pak se 6 euro që nuk ka ndonjë mundësi të zbatohet kërkesa juaj. Raporti nuk është i votuar unanimisht dhe ka kundërthënie mes anëtarëve të komisionit dhe nuk e kuptojmë mbi çfarë bazë është rekomanduar në OE i papërgjegjshëm. Me datë 03.08.2023 kemi pasur qasje në ofertën e OE të rekomanduar dhe pamë se ky OE ka edhe mungesë dokumentacioneve dhe nuk ka plotësuar respektuar kërkesat e AK, OE në fjalë nuk ka ofruar si propozim kërkesën tuaj në Aneks 1 përkatësisht pika 7 nën kërkesa d. Me qellim te rritjes se efektivitetit te sigurisë ne objektet e veta. Autoriteti Kontraktues e konsideron si domosdoshmëri monitorimin e rojeve neper objektet e saja ne kohe reale përgjatë gjithë kohës (24/7/365). Për tu arritur kjo Autoriteti Kontraktues kërkon qe kompanitë e sigurimeve te posedojnë zgjidhje elektronike qe do te mundësonte kontrollin e rojeve ne terren ne kohe reale gjate tere kohës. Softuerin dhe infrastrukturën përkatëse qe i mundëson Autoritetit Kontraktues te beje monitorimin e rojeve.

- *Pretendimi i dytë (II):* OE është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka respektuar kërkesën tuaj ku keni kërkuar që për shujte me një ofrues te shërbimeve te ushqimit. (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€). Në analizën e ofruar nga ky OE deklaron se çmimin për shujtë e ka ofruar në vlerë prej 1.13 që dëshmon se nuk ka respektuar kërkesën e dosjes së tenderit.
- *Pretendimi i tretë (III):* Tek menaxheret është bo ndryshim çmimi gjë që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit kjo për arsye se ky ka dhen çmim për një ditë me vlerë prej 113.60 x 365 = 41,464.00 kurse në analizë 36 mijë edhe këtu është ndryshim në aspektin material. Sa i përket uniformave dhe pajisjeve tjera ne në depo kemi uniforma të mjaftueshme për t'i pajisur të gjithë punëtoret e angazhuar në këtë kontratë. Gjithashtu, grupi jonë ka pajisje të mjaftueshme për t'i pajisur te gjitha pikat sipas kërkesës se specifikimit teknik. Kompania jonë është e fokusuar në bashkëpunime afatgjatë dhe rëndësi të veçanta janë referencat me c'rast në këtë tender kemi paraparë fitim minimal për të mos thënë fare. Të gjitha ofertat që janë nën çmimin e ofruar janë të papërgjegjshëm. Me datë 07.08.2023 kemi pranuar me email një dokument nga ju certifikatën e ekspertit për shëndet dhe siguri në punë dhe listën për verifikim dhe pamë se sipas nr të certifikatës me nr 233 del të jetë person tjetër që shfaq dyshimin tonë se kjo çertifikatë nuk është valide. Duke u bazuar në të gjeturat nga ana jonë dhe shkeljet që janë bërë kërkojmë nga ana juaj që të aprovoni kërkesën tonë për rishqyrtim duke shpallur ofertën tonë si më të lirën të përgjegjshme.
- *Pretendim i katërt (IV):* AK përveç se nuk marrë mundin të na shqyrtoj kërkesën tonë konform nenit 108/A ku në kërkesë për ri-shqyrtim kemi ofruar mjaftë argumente se ka shkelje esenciale të ligjit madje ka edhe ndryshim në aspektin material të ofertës dhe se me kërkesën të cilën AK cekë. Po ashtu ky OE është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka respektuar kërkesën tuaj ku keni kërkuar që për shujte me një ofrues te shërbimeve te ushqimit (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€). Në analizën e ofruar nga ky OE deklaron se çmimin për shujtë e ka ofruar në vlerë prej 1.13 që dëshmon se nuk ka respektuar kërkesën e dosjes së tenderit. Ky mos zbatim i kërkesës e bënë direkt të pa përgjegjshëm këtë OE. Por AK nuk e ka marrë për bazë dhe na ka vendosur në lajthitje edhe neve se nëse një kërkesë e tillë nuk ish dashur të "zbatohet" pse ka kërkuar një gjë të tillë përderisa nuk është bërë vlerësimi konform kërkesave.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Security Code" Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* Në dosjen e përgatitur të tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka bërë diskriminim të OE. Në njoftimin për tenderuesin e eleminuar dhe shkaqet që do të bashkëngjitet bashkë me këtë ankesë, AK në raportin e vlerësimit të dytë njofton se ne nuk

kemi ofruar dëshmi për përvojën e projekt menaxherit dhe mbikëqyrësit e rojeve. Në DT, AK nuk ka kërkuar kurrfarë dokumenti me të cilin do të paraqitet përvoja e projekt menaxherit dhe mbikëqyrësit të rojeve, por në bazë të kërkesave të MPB – Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë, në momentin kur një person kërkon të pajiset me licencë të Menaxherit kërkohet përvoja e punës 3-vjeçare për t'u pajisur me licencën adekuate, andaj ne si OE jemi bazuar në kërkesat e MPB dhe ofrimin e licencës valide si kërkesë dhe dëshmi për punëtorët e angazhuar për këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu, AK në momentin e pranimit të tenderëve ka të drejtën të kërkojë sqarim të dosjes së tenderit nga OE për dokumentet të cilat nuk kanë qenë të ngarkuara dhe të cilat nuk do të shkaktojnë devijime të cilat mund të ndryshojnë DT. Në analizën financiare të ngarkuar nga OE fitues vërejmë se ofertimi për shujtë është në vlerë prej 1.13€ kurse kërkesa e AK është që minimum të jetë 2.00€ (prova 1), ky ofertim padyshim që është diskriminues dhe jo ne harmoni me kërkesën e DT pasi që është e qartë dhe fakt notor që secili OE do të jetë më i ulët në çmim kur oferton nën vlerat dhe pragun që i ka vendosur AK. Gjithashtu, në sigurimin shëndetësor OE fitues ofertojnë me një çmim prej 8.00€ shumë e cila nuk mbulon as përqindjet më të vogla të sigurimit të kërkuar nga AK dhe me të cilin konstatohet se OE fitues ka ofruar sigurim shëndetësor sipas vullnetit të tyre të lirë dhe në kundërshtim me kërkesat e DT. Gjithashtu, para marrëveshjet e OE tjerë pjesëmarrës me shumën mujore prej 7.50€ në muaj për punëtorë është shumë e habitshme dhe konfuze duke parë kërkesat e AK rreth sigurimit shëndetësor dhe specifikimeve në tabelën e sigurimit shëndetësor, pasi që asnjë kompani e sigurimeve e rregulluar me tarifat e BQK nuk mbulon sigurim shëndetësor me shumë 7.50€. Tarifa minimale sipas BQK është 20.00€. Në analizën financiare të ngarkuar nga OE i dytë (Defence Security), në analizën financiare vërejmë se vlera e uniformës nuk është ngarkuar në analizë financiare pasi OE pretendon se ka uniforma të mjaftueshme për të gjithë punëtorët. Secili OE pjesëmarrës mund të deklarojë se ka uniforma të mjaftueshme për të siguruar për punëtorët me të gjitha kërkesat e AK, por kërkesat e AK janë të njëjta për të gjithë OE pjesëmarrës sepse ne Analizë Financiare kërkohet vlera totale e uniformës. Po ashtu, në këtë mënyrë duke mos llogaritur uniformën apo shpenzimet tjera të parapara OE tjerë mund të dalin fitues pasi çmimi final i tyre kuptueshëm është abnormalisht më i ulët. (prova 2) . Po ashtu departamenti financiar i kompanisë e ka vërtetuar se pas analizimit të ofertave të të gjithë OE kanë ofertuar me çmim abnormal te ulët dhe nën pragun e vendosur nga AK për pagën bazë të caktuar 386.00€ dhe shtesat tjera ne harmoni me Ligjin e punës ne fuqi; 30% orët e natës; 50% ditët e festive si dhe pushimin me pagesë. *Referoju dosjes së tenderit, faqe 22 tek specifikimet teknike pika 4.Neni 11 par.3 nën.par.3.2 (Informatat Sekrete Afariste)*. Argument: Neni i parashtruar në LPP tregon se çka mund të konsiderohet si sekret afarist me të cilin edhe mbrohet ai sekret, është jo e drejtë kërkesa për konfidencialitet të të gjitha licencave dhe dokumenteve të kërkuara nga AK dhe kjo rrjedhimisht mbyll mundësitë për të parë nëse OE i përshtatet specifikave të kërkuara nga AK. Në programin e MPB (SSHPS) me numër të identifikimit personal mund të evidentosh secilin punëtorë që ka licencë valide gjithashtu datën e aplikimit, datën e statutit, llojin e shërbimit, numrin e certifikatës dhe të gjitha të dhënat tjera të cilat shërbejnë për nevoja të MPB, pra këto janë informata publike të cilat secili OE mund t'i përdorë dhe të ketë qasje pasi me këtë program kryhet aplikimi i të gjitha licencave që kërkohen nga MPB. Hiearkia ligjore në këtë rast i bie që AK të jetë zbatues dhe ekzekutues i normave legjislative dhe të veprojë në përputhshmëri me normat ligjore dhe rregullative të RKS. Andaj, të klasifikosh si sekret afarist pothuajse tërë dosjen e tenderit edhe pse në par.3 nënpar.3.3 tregohet shprehimisht se cilat informata mund të klasifikohen si sekrete ngrit dyshimet nëse OE fitues në këtë rast i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për t'u shpallur fitues.

- *Pretendimi i dytë (II):* Ne, si tenderues në këtë aktivitet të prokurimit kemi ofruar zgjidhje në mënyrë me plotësimin e kërkesave të definuara nga AK andaj eliminimi jonë nga ky tender nuk është adekuat pasi që edhe në arsyetimin e dhënë më lartë nga ne, OE "SECURITY CODE" SH.P.K arsyeton se ofrimi i kërkesave nga ana jonë është në përputhshmëri me kërkesat e AK. Kërkesat për ofrim të përvojës nga AK për mbikëqyrësit e zonave dhe projektmenaxherin përmbajnë: kontratë apo parakontratë, licencë valide, diplomë të shkollës së mesme, në përmbajtje të kësaj ne si OE kemi ngarkuar tri (3) kërkesat e AK dhe në kërkesë për përvojë kemi arsyetuar se AK do të bazohet në licencat e pjesëmarrësve të tenderit pasi që secili person që dëshiron të pajisjet me licencë të menaxheri duhet të ketë tri (3) vite përvojë pune në lëminë e sigurimit fizik, por kjo kërkesë neve si OE na ka vënë në lajthitje për shkak se në raportin e vlerësimit të dytë klasifikohen si lëshim nga ana jonë mos-ofrimi i përvojës së punës së personave pjesëmarrës në këtë tender dhe gjithashtu si OE jemi të gatshëm të dëshmojmë përvojën e secilit menaxher dhe secilit dokument të ngarkuar në momentin që AK kërkon duke qenë se kompania jonë operon nga viti 2008 në lëminë e sigurimit fizik dhe është e paarsyeshme dhe e njëjta shkakton dëmtim të imazhit të kompanisë nëse eleminimi jonë vie si shkak i mosparaqitjes së përvojës së punës edhe pse nuk është kërkesë e AK trusti apo vërtetimi. Sipas Ligji për Shërbimet Private të Sigurisë (Nr.04/L-004), neni 18 (Kushtet shtesë për licencimin e punëtorit të specializuar të sigurimit) paragrafi 5 cek: *Përveç plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji, menaxheri i sigurimit/zyrtari në detyrë duhet të plotësojë edhe këto kushte:5.1. të ketë arritur moshën njëzetenjë (21) vjeçare;5.2. të ketë tri (3) vjet përvojë pune në fushën e sigurisë;5.3. të ketë përfunduar shkollimin e mesëm;5.4. të ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit/zyrtar në detyrë dhe të posedojë certifikatën që e dëshmon këtë;5.5. të ketë kaluar me sukses provimin e organizuar nga organi kompetent.* Rrjedhimisht lëshimi i licencës nga MPB për Menaxherët tonë është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe arsyeton faktin e përvojës së kërkuar nga AK për projektmenaxherin 3 vite dhe për mbikëqyrësit e zonave 2 vite. Në mos përmbushjen e ofrimit të kontratave dhe referencave nga ne sipas AK, deklarojmë se vetëm me KEK kemi pasur bashkëpunim të mirë më shumë se 6 vite dhe me të njëjtin AK kemi lidhur kontrata të ndryshme, ku performanca jonë ka qenë serioze dhe efektive, këtë e vërtetojnë edhe referencat të cilat i kemi marrë nga AK. (Kompania jonë vetëm në KEK ka operuar më shumë se 6 vite, të bashkangjitur gjeni referencat nga KEK).
- *Pretendimi i tretë (III):* Neni 57 par.4 nënpar.4.2 dhe 4.3 (Sigurimi i Tenderit) Sigurimi i tenderit është verifikuar edhe një herë në kompaninë e sigurimeve përkatëse. Vlefshmëria e tij është 120 ditë. Po ashtu, mund të verifikohet në kompaninë e sigurimeve EUROSIG me Nr. policës 271/23.
- *Pretendimi i katërt (IV):* Neni 59 par.2 dhe 4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve). AK në rastin e ekzaminimit të tenderëve vlerëson dhe krahason tenderët, gjithashtu në këtë proces mund të konstatojë edhe mungesat e nevojshme të cilat nuk janë ngarkuar nga OE pjesëmarrës për shkak të lëshimeve teknike, por që LPP siguron të drejtën e AK që t'i drejtohet OE pjesëmarrës për lëshimet të cilat janë evidentuar në "Kërkesën për sqarim të tenderit", me të cilën ne mund të kishim konstatuar lëshimet tona dhe eventualisht t'i ngarkojmë në platformën e-prokurimi për t'i ofruar AK të gjitha kërkesat të cilat nuk kanë qenë pjesë e tenderit të ofertuar nga OE por që janë kërkesa të cilat janë bërë nga AK. Gjithashtu, ne shohim se Zyrtarët për siguri dhe shëndet në punë nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, nuk përmbushin kërkesat e nevojshme për shkak se me datë 31.03.2023 ka qenë afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për shtyrjen e afatit të validitetit të certifikatës, e gjitha kjo e bazuar me Rregulloren Nr.01/2021, përkatësisht në Dispozitat

Kalimtare neni 37 par.1. Këtu përcaktohet se certifikatat e Ekspertëve janë valide për dy (2) vite nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore dhe e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.04.2021, dhe rrjedhimisht me këto dispozita rregullohet se zyrtarët të cilët nuk kanë ndjekur udhëzimet e nevojshme atëherë certifikata e tyre është e pavlefshme. Pra, ne vlerësojmë se ky krahasim i ofertave është i padrejtë dhe diskriminues ndaj tjerëve. AK në e-mail zyrtar na ka dërguar linkun ku mund të verifikohen certifikatat e zyrtarëve për siguri dhe shëndet në punë dhe sipas këtij linku të gjitha OE i kanë të skaduara. Shiko linkun e bashkangjitur: https://mpms.rks-gov.net/pwdm-package/lista-e-eksperteve-te certifikuar-per-sigurine-dhe-shendetin-ne-pune-2/ (prova 4).

- *Pretendimi i pestë (V): Neni 72 (Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë).* Marrë parasysh se AK ruan të drejtën për të kërkuar informatat shtesë dhe dokumentacionin e nevojshëm, ne si OE e shohim të papërshtatshme që vetëm disa OE të jeni të 'privilegjuar' për të dhënë informatat shtesë, duke parë se dokumentacioni jonë është krejtësisht i çështjes teknike dhe i cili nuk përbën asnjë ndryshim apo devijim nga DT, andaj trajtimi nuk është bërë i barabartë dhe transparent ashtu siç kërkon par.1 i nenit 72. Pra, në bazë të të lartcekurave dhe konform nenit 105 par.2.7 dhe 2.8, kërkojmë nga Bordi Drejtues i OSHP-së, që këtë aktivitet të prokurimit sikurse ceket në nënparagrafet e LPP, ta anulojë dhe të njëjtin t'a rikthejë në procedurë fillestare.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "S.I.G" Sh.P.K janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë për aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëcekura një OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit dhe në mënyrë të padrejtë e ka eleminuar nga aktiviteti i prokurimit, kompaninë tonë e cila ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit. Pas pranimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e gjithë aktivitetit të prokurimit konform par.3 të Nenit 10 të LPP-së. Autoriteti Kontraktues nuk na ka lejuar qasje të plotë në të gjithë dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, por ka ofruar vetëm qasje të kufizuar duke na treguar në kompjuter vetëm disa pjesë të OE të rekomanduar për kontratë, duke na mohuar të drejtën e qasjes konform dispozitës së Nenit 10 të LPP-së, të njëjtit nuk na kanë ofruar që dokumentet të i pranojmë përmes USB, pasi që janë thirrur në konfidencialitet/sekret afarist, mirëpo Neni 11 i LPP-së përkatësisht par.4 i LPP-së e rregullon këtë çështje ku thuhet se AK një element brenda dokumentit të klasifikuar si sekret afarist duhet të përgatis versionin e "pastruar", gjë që nuk është bërë nga Autoriteti Kontraktues. Andaj ne jemi krejtësisht të diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform Nenit 7 të LPP-së, si për rastin e eleminimit të kompanisë sonë poashtu edhe në rastin e ofrimit të qasjes në dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit. Me rastin e mos pranimit të dokumentacionit të këtij aktiviteti të prokurimit në përgjithësi dhe dokumenteve të OE të rekomanduar në veçanti dyshojmë se i njëjti nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, pasi që janë disa dokumente që nuk kemi arritur ti shohim se të njëjtat i njëjti i posedon, andaj mbetet obligim i ekspertit shqyrtues dhe panelit të OSHP-së të vërtetoj nëse i njëjti i plotëson dhe i posedon dokumentet e kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Sipas procesverbalit të datës 12.06.2023 të hapjes së tenderëve janë pranuar gjithsejt 7 oferta. Sipas vendimit të datës 02.08.2023 Autoriteti Kontraktues nxjerr rezultatin se nga gjithsejt 7 oferta vetëm 2 janë pranuar si të përgjegjshme, OE i rekomanduar për kontratë "Internat Security Association ShPK" dhe OE me emër tregtar "Defence Security Shpk & International Security AAH Shpk".

- *Pretendimi i dytë (II):* Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar Nenin 1 të LPP-së pasi që Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, autoritetet kontraktuese. Autoriteti Kontraktues me rastin e përcaktimit të kërkesave të saja për këtë procedurë të prokurimit në vete së pari nuk e ka respektuar qëllimin e aktivitetit te prokurimit pasi që ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë dhe ka shkelur kërkesat e veta, duke na vu në lajthim operatorët ekonomik të tjerë të cilët i kemi zbatuar në përpikëri të gjitha kërkesat e parashtruara. Poashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e Nenit 7 të LPP-së pasi që nuk na ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet të prokurimit sepse Analizat financiare të asnjë operatori ekonomik nuk janë vlerësuar dhe krahasuar konform Nenit 59.4 të LPP-së sepse të gjitha kërkesat kanë qenë mjaft të qarta dhe janë dhënë mjaftë sqarime për të përgatitur ofertuesit ofertat e tyre në bazë të kërkesave duke respektuar Ligjin e Punës Nr.03/L-212. Në mënyrë të qartë kanë qenë të cekura dhe të specifikuara kërkesat në bazë të Nenit 28 të LPP-së specifikimet teknike të detyrueshme e për të cilat kemi qenë të obliguar ti respektojnë sipas udhëzimeve të dhëna nga Autoriteti Kontraktues e më pastaj të njëjtat kërkesa gjatë vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave konform Nenit 59.4 të LPP-së nuk janë respektuar, dhe në mënyrë jo të drejtë eliminohemi.
- *Pretendimi i tretë (III):* Autoriteti Kontraktues me datën 09.08.2023 nxjerr vendim duke refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim si të pabazuar duke mos u përgjigjur të gjitha pretendimeve tona ankimore edhe pse i njëjti është i obliguar që sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022 të na përgjigjet secilit pretendim ankimor, AK nuk trajton pjesën ku kemi dëshmuar "përgjegjshmërinë" e ofertës sonë, si dhe jep mendimet e veta lidhur me eliminimin e kompanisë sonë në mënyrë të padrejtë dhe tendencioze edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Kompania jonë ashtu siç e kemi cekur edhe në kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 06.08.2023 është eliminuar padrejtësisht në mënyrë tendencioze pasi që është e vetmja kompani se ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë sipas Aneksit 1 të vendosura në Specifikimet teknike të Detyrueshme. Eliminimi i kompanisë sonë në arsyetim se: Keni dëshmitë se posedoni vetëm dy vetura të dokumentuara për shfrytëzim në bazë të kërkesës në DT, ndërsa për veturat tjera mungon dokumentacioni që anëtarët e konsorciumit i kanë në shfrytëzim. Kompania jonë e ka kundërshtuar eleminimin e kompanisë sonë në arsyetimin e cekur, pasi që ne kemi vendosur numër të mjaftueshëm të dokumenteve lidhur me veturat e kërkuara, ne poashtu kemi bashkangjitur të gjitha marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre me qira nga kompanitë bashkëpunuese. Ashtu siç e kemi potencuar në kërkesën për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave nuk e ka bërë konform Nenit 59.4 të LPP-së, pasi që në njërën anë ofertën e OE të rekomanduar për kontratë e krahason si të përgjegjshme, në anën tjetër ofertën tonë e eleminon pa asnjë bazë ligjore në mënyrë tendencioze. Konzorciumi ynë "SIG ShPK & Group for Security ShPK" në ofertë ka të vendosur gjithsejtë 10 vetura, kurse kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë të vendosen 4 vetura patrulluese.
- *Pretendimi i katërt (IV):* Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet "SIG ShPK" dhe "Jaguar Security ShPK" i datës 09.06.2023 saktësisht në Nenin 3 specifikohet qartazi se "Dokumentet e veturave të kompanisë Jaguar Security ShPK të cilat i ka në emër të saj apo kompanive të tjera me të cilat ka marrëveshje Rent a Car Mara dhe Elron ShPK, për të cilat kompania

Jaguar Security ShPK ka marrëveshje të lidhura me këto kompani për marrjen e veturave me qira gjithashtu i lejohet se të njëjtat vetura të këtyre dy kompanive të lartëcekura do të mund ti përdor për këtë tender, gjë që i lejohet dhe i jepet kjo e drejtë nga ana e kompanisë Jaguar Security ShPK". Andaj Autoriteti Kontraktues pa të drejtë po e ri-potencojmë se na ka eleminuar padrejtësisht në këtë aktivitet të prokurimit. Me rastin e eleminimit të ofertës sonë në arsyetim se nuk kemi plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues dhe nuk kemi ofruar dëshmi në përmbushjen e kërkesës për 4 vetura, dhe se marrëveshja e ofruar nga ana jonë për shfrytëzimin e veturave nuk është cilësuar si valide. Ky arsyetim nuk është ligjor pasi që marrëveshjet e dorëzuara tërësisht janë ligjore dhe valide dhe nuk mund të konsiderohen ashtu siç i ka konsideruar Autoriteti Kontraktues si jo valide për shkak se në asnjë dispozite të atyre marrëveshjeve nuk e specifikon se ndalohet dhënia e automjeteve në shfrytëzim të ndonjë palë e tretë, poashtu në rastin në fjalë Autoriteti Kontraktues për të hequr dilemat që ju kanë shfaqur gjatë vlerësimit ka mundur që në bazë të Nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë lidhur me marrëveshjet dhe jo në mënyrë të padrejtë të na eleminoj për diçka të tillë. Kompania jonë poashtu gjatë hartimit të ofertës (çmimit) është bazuar në të gjitha elementet e cekura në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit dhe Aneksin 1 tek specifikimet teknike të detyrueshme ku ka kërkuar që Ligji i Punës Nr.03/L-212 të respektohet në tërësi e që kjo nënkupton se të gjithë ofertuesit kanë qenë të obliguar që gjatë hartimit të çmimit të respektojnë dispozitat ligjore të këtij Ligji e në veçanti Nenin 56 të Ligjit të Punës ku parashihet pagesa shtesë si dhe Neni 32 i Ligjit të Punës (pushimi vjetor), e që asnjë operator ekonomik i cekur si më poshtë nuk ka respektuar këto kërkesa me crast i bie se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar konform Nenit 59.4 të LPP-së dhe nuk ka respektuar kërkesat e veta të cekura, e që i bie se ne si operator ekonomik jemi vu në lajthitje. Operatorët ekonomik si më poshtë pos që janë eleminuar nga ana e Autoritetit Kontraktues për shkak të mungesës së dokumentacionit të njëjtit nuk janë të përgjegjshëm financiarisht për shkak se nuk kanë vepruar konform kërkesave për respektimin e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, andaj edhe nuk mund të konsiderohen si palë me interes konform Nenit 4 par.1.26 të LPP-së. 1. OE - Bold Security ShPK & Drita Security ShPK (çmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212). 2. OE SAS ShPK (çmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212). 3. OE - Internat Security Association ShPK (çmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i njëjti poashtu ka mungesë të dokumenacionit dhe është dashur të eleminohet e jo të rekomandohet). 4. OE Defence Security ShPK & International Security AAH ShPK (çmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i njëjti poashtu ka mungesë të dokumentacionit dhe është dashur të eleminohet e jo të rekomandohet). 5. OE Rojet e Nderit ShPK (çmimi i ofertuar nuk mbulon kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar pagesat shtesë dhe pushimin vjetor sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212). Kurse sa i përket OE Security Code ShPK i njëjti ka rezultuar edhe si më i shtrenjti dhe është eleminuar në mungesë të listës së kontratave dhe referencave, andaj nuk mund të cilësohet edhe i njëjti si palë e interesit.

- *Pretendimi i pestë (V):* OE i rekomanduar për kontratë "Internat Security Association Shpk" pretendojmë se nuk është i përgjegjshëm qoftë administrativisht (në dokumentacion) poashtu edhe financiarisht (sipas analizës financiare). Në kërkesë për rishqyrtim e kemi cekur se i njëjti Analizën financiare të prezantuar e ka të gabuar dhe jo të plotë konform asaj se çfarë është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit/ Aneksin 1 tek specifikimet

teknike të detyrueshme. Gjatë qasjes së kufizuar në dokumentet e po këtij operatori ekonomik kemi hasur se i njëjti nuk e përmbush kërkesën nr.2 pika b), ku zyrtari i ngarkuar për shëndet dhe siguri në punë nuk e ka vendimin valid të ri-certifikimit të MPMS-së. Ne e kemi atakuar këtë pikë gjatë kërkesës për rishqyrtim, kurse Autoriteti Kontraktues ka dhënë një shpjegim formal dhe jo të bazuar konform dokumentacionit të duhur. Certifikata e ofruar nga ana e OE për personin Shaban Hereqi i cili nuk është i ricertifikuar me vendim nga ana e MPMS. Poashtu dyshojmë se dëshmitë e tjera si: dokumentet e 4 menaxherëve të zonave nuk i përmbush ky Operator Ekonomik i rekomanduar për kontratë, pasi që nuk na është lejuar shiqimi i dokumenteve të këtyre personave që ka angazhuar. I njëjti dyshohet se nuk ka plotësuar kërkesat e tjera konform Nenit 69 të LPP-së, andaj kërkohet që të vërtetohet se i njëjti ka të vendosura dokumentet e kërkuara sipas pikës 1,2,3,4 të Nenit 69 të LPP-së. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në dosjen e tenderit përkatësisht tek Aneks 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme: *4. Duke marr parasysh rëndësinë e objekteve qe duhet te ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për autoritetin kontraktues. Paga minimale bruto bazë (te pagesave shtese dhe lejimeve konform Ligjit të Punës ne fuqi), për roje fizike të angazhuar ne ketë kontratë duhet të jetë jo me pak se 386 € ne muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar qe te respektoj Ligjin e punës dhe Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2017 . Ne këtë rast Kontraktori obligohet te paguaj shtese mbi pagën baze për ndërrimin e dyte dhe te trete dhe festa. Kontraktori obligohet te furnizoje edhe një shujtë te ngrohte për çdo ndërrim. Duke iu referuar Ligjit te punës ne fuqi dhe UA te ndërlidhura, fondi orëve për një muaj është 176 për një muaj.5. OE obligohet te angazhoje edhe një Projekt menaxher dhe 4 mbikëqyrës te zonave. Projekt menaxheri si dhe te 4 mbikëqyrës (menaxherë) te zonave te kërkuar sipas DT kane obligim te jene te angazhuar dhe te janë prezent ne zonën e sigurisë se KEK-ut dhe zonat e veta si vend pune te vetëm (se paku 8 ore ne dite gjate pese (5) ditëve te javës) dhe kane përgjegjësi te plote për zonën e vet. Paga minimale për një menaxher duhet te jete minimum 500 € /muaj.* Andaj manipulimi i bërë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë tek Analiza Financiare e që nuk ka përfshirë të gjitha elementet e kërkuara ka rezultuar në mos trajtim të barabartë dhe në mënyrë diskriminuese vepron gjatë vlerësimit, e që komisioni nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 59.4 të LPP-së. Neni 38.5 i Rregullores Nr.001/2022 dhe Neni 72.1 tregon qartazi se: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Poashtu Autoriteti Kontraktues është në dijeni se në bazë të Nenit 69.8 të LPP-së ne si Operator ekonomik kemi të drejtën e mbështetjes në kapacitetet subjekteve të tjera: "Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera". Përfundimisht eleminimi i kompanisë sonë është në kundërshtim edhe me Nenin 40.12 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues vlerësimin e ofertave përfundimisht nuk e ka kryer në bazë të Nenit 59.4 të LPP-së dhe Nenit 60 pasi që kriteri

kryesor ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët e që në këtë rast ofertuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë Analizë financiare sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues kështu që duke manipuluar me shifrat dhe vlerat në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës Nr.03/L-212. Andaj edhe ju me rastin e rekomandimit të këtij operatori ekonomik keni rënë në kundërshtim edhe me Nenin 17.31 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin publik pasi që kjo dispozitë thotë se "Ofertat nga ofertuesit të cilët nuk kanë marrë parasysh obligimet e dispozitave të mbrojtjes së punëtoreve dhe kushteve të punës të identifikuara nga autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës nuk mund të konsiderohen si në përputhje me dokumentet e kontratës. Për më tepër, kur ofertuesit nuk marrin parasysh në mënyre të mjaftueshme këto detyrime në tenderët e tyre, tenderët e tyre mund të konsiderohen si jo-normalisht të ulët dhe mund të refuzohen për këtë arsye." Tek ky Operator ekonomik gjatë kalkulimeve që i ka bërë shihet se nuk janë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për shkak se llogaritja e çmimit njësi për orë pune nuk është konform Nenit 56 të po këtij ligji pasi që parashihen pagesat shtesë si: orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarive si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmangur kalkulimit të saktë, me crast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të bëjë llogaritje të saktë. Tek ky Operator ekonomik gjatë kalkulimeve që i ka bërë shihet se nuk janë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për shkak se llogaritja e çmimit njësi për orë pune nuk është konform Nenit 56 të po këtij ligji pasi që parashihen pagesat shtesë si: orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarive si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmangur kalkulimit të saktë, me crast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të bëjë llogaritje të saktë.

- *Pretendimi i gjashtë (VI):* Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues t'i trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente. Konsiderojmë se AK na eleminon pa kurrfarë baze dhe padrejtësisht na shkakton dëme në mënyrë që të favorizon kompaninë e rekomanduar për kontratë dhe ne si palë e dëmtuar do të vazhdojmë ankimimet tona për shkaktimin e dëmit në këtë procedure në instanca të tjera nëse nuk riparohet vendimi dhe vlerësimi konform Nenit 59.4 të LPP-së. Par.4 i Nenit 59 të LPP-së thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Andaj bazuar në të gjitha të gjeturat dhe të cekurat më lartë konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues aktivitetin e prokurimit Vlerësimin, krahasimin dhe Ekzaminimin e tenderëve nuk e ka bërë konform Nenit 59.4 të LPP-së, me ç'rast nuk ka respektuar edhe kërkesën-riterin kryesor e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas Nenit 60 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues me datën 31.08.2023 ka dorëzuar raportin e ekspertizës duke rekomanduar që: "...A*nkesat e operatoreve ekonomik ankues "Defence Security SH.P.K. dhe OE "S.I.G, të aprovohen si te bazuara, ndërsa ankesa e OE "Security Code" si pjesërisht e bazuar, të anulohet vendimi i AK-se për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim*". Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të gjitha palët procedurale. AK lidhur me mendimin e ekspertit ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE "Defence Security" është pajtuar, OE "Security Code" nuk është deklaruar, dhe OE "S.I.G" është pajtuar me rekomandimet e ekspertit.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me tutje, lidhur me pretendimet e OE "Defence Security" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0593 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):* Eksperti Shqyrtues pas analizimit, krahasimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar, gjendet kalkulimi mbi pagën dhe çmimin ofertues, dhe si rrjedhojë vërejmë se, pas kërkesës për sqarim nga ana e AK-së për të gjithë operatorët, në të cilën kërkesë AK kërkon që të bashkëngjiten analizat financiare, dhe si e tillë në E-prokurim me datë 20.06.2023 nga OE i rekomanduar është bashkangjitur analiza financiare, ku shihet se OE i rekomanduar ka kalkuluar shujtën e punëtorëve me çmimin 1.13 euro, gjersa AK në DT ka kërkuar që shujta mos të jetë më e ulët se 2 euro, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Eksperti Shqyrtues sqaron se, sa i përket anëtarëve të komisionit, ka një kundërshtim dhe mos votim unanim, si e tillë pretendimi gjendet i bazuar.
- *Konstatimi i dytë (II):*Eksperti Shqyrtues sa i përket pretendimit lidhur me certifikatën e ekspertit për shëndet dhe siguri në punë sqaron se, OE i rekomanduar ka të bashkangjitur certifikatën për dhënie te provimit me date 12.12.2020, ku pas verifikimit ne faqen zyrtare te MPB-se te lista e eksperteve te certifikuar për sigurinë dhe shëndetin ne pune, gjendet emri i te njëjtit zyrtar si dhe data e provimit dhe si e tille pretendimi nuk gjendet i bazuar.

Për pretendimet e OE "Security Code" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0594 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):* Eksperti Shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE ankuesit janë të ngarkuara, deklarata mbi projekt menaxherin, licenca valide për siguri dhe shëndet në punë, po ashtu edhe kontratën e punës, mirëpo AK ka eliminuar OE ankuesin që nuk ka bashkangjitur përvojën e punës, e cila mundet të sqarohet konform nenit 72 të LPP-së, po ashtu edhe sipas Ligjit për shërbime private të sigurisë secili aplikues për licencë duhet të posedoj përvojë pune varësisht nga natyra. Dhe si e tillë sa i përket Projekt menaxherit pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.
- *Konstatimi i dytë (II):*Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar, gjendet paramasa mbi çmimin ofertues, dhe si rrjedhojë vërejmë se, pas kërkesës për sqarim nga ana e AK-së për të gjithë operatorët, në të cilën kërkesë AK kërkon që të bashkëngjiten analizat financiare, dhe si e tillë në E-prokurim me datë 20.06.2023 nga OE i rekomanduar është bashkangjitur analiza financiare, ku shihet se OE i rekomanduar ka kalkuluar shujtën e punëtorëve me çmimin 1.13 euro, gjersa AK në DT ka kërkuar që shujta mos të jetë më e ulët se 2 euro, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Kurse sa i përket pretendimit për ofertuesit të cilët kanë kalkuluar sigurimin

shëndetësor në vlera 6 euro, 7.5 euro, 8 euro, konsideroj se gjendet e bazuar, për faktin se personalisht kam hulumtuar çmimet dhe si rrjedhojë kushtojnë mbi 20 euro, mirëpo AK sugjerohet që të hulumtoj tregun, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

- *Konstatimi i tretë (III):* Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin për OE "Defence Security" SHPK sqaron se, OE i dytë (Defence Security) ka të bashkangjitur analiza financiare, pas kërkesës për sqarim nga AK, dhe si e tillë OE në fjalë ka të bashkangjitur analizën, kurse për uniformat i njëjti ka dhënë sqarim më poshtë, mirëpo është në diskrecion të AK-së të kërkoj sqarime nëse ka çmim abnormalisht ulët.
- *Konstatimi i katërt (IV):* Eksperti Shqyrtues, sa i përket arsyes tjetër të eliminimit lidhur me listën e kontratave dhe referencave sqaron se, në ofertën e OE ankues nuk gjendet lista e kontratave të realizuara brenda tri viteve të fundit, dhe si e tillë konform udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, meqenëse nuk posedon Listë të kontratave atëherë refuzohet tenderi.
- *Konstatimi i pestë (V):* Eksperti Shqyrtues sa i përket arsyes tjetër të eliminimit të OE ankues lidhur me sigurimin e tenderit sqaron se, i njëjti ka të bashkangjitur sigurimin, e cila ka validitet të shkruar nga vet kompania e sigurimit "Eurosig", mirëpo AK mundet ta verifikoj tek kompania në fjalë nëse ka dyshime, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.
- *Konstatimi i gjashtë (VI):*Eksperti Shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues sqaron se, në listën e publikuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, gjendet emri i zyrtarit i cili është i potencuar nga OE i rekomanduar si Menaxher për shëndet dhe siguri në punë, dhe si e tillë pretendimi nuk gjendet i bazuar. Tutje, sa i përket qasjes, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet aneks 3 kërkesa për konfidencialitet, ku AK duhet që të klasifikoj informatat sekrete afariste, të cilat konsideron se mund ta dëmtojnë operatorin ekonomik në ofertë, mirëpo për pjesën tjetër duhet qe ti ipet qasja, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE "S.I.G." SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0597 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):*Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet aneks 3 kërkesa për konfidencialitet, ku AK duhet që të klasifikoj informatat sekrete afariste, të cilat konsideron se mund ta dëmtojnë operatorin ekonomik në ofertë, mirëpo për pjesën tjetër duhet qe ti epët qasja, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.
- *Konstatimi i dytë (II):* Eksperti Shqyrtues sa i përket arsyes së eliminimit të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE ankuesit gjenden disa vetura, të cilat kanë marrëveshje me një kompani, e cila po ashtu ka marrëveshje me kompaninë tjetër, dhe si e tille, AK sa i përket dokumenteve ne oferte gjatë procesit të vlerësimit ka mundur te kërkoj sqarime konform nenit 72 të LPP-së, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.
- *Konstatimi i tretë (III):* Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit te OE ankues kundër OE te rekomanduarit sqaron se, lidhur me kërkesën nr.2 pika b), ku zyrtari i ngarkuar për shëndet dhe siguri në punë nuk e ka vendimin valid të ri-certifikimit të MPMS-së, OE i rekomanduar ka të bashkangjitur certifikatën për dhënie te provimit me date 12.12.2020, ku pas verifikimit ne faqen zyrtare te MPB-se te lista e eksperteve te certifikuar për sigurinë dhe shëndetin ne pune, gjendet emri i te njëjtit zyrtar si dhe data e provimit, dhe si e tille pretendimi nuk gjendet i bazuar, po ashtu sa i përket kërkesës për 4 menaxher te zonës, kemi verifikuar në ofertë dhe janë te licencuar ne fushën private te sigurisë nga MPB.
- *Konstatimi i katërt (IV):* Eksperti shqyrtues sqaron se, OE i rekomanduar sa i përket analizës konsideroj se nuk ka futur ne kalkulim si psh. shujtën konform DT-se, pra kërkesa e AK-se

ka qenë minimum 2 euro shujte ditore, gjersa OE i rekomanduar ka kalkuluar shujtën me 1.13 euro, dhe si e tille pretendimi gjendet i bazuar.

- *Konstatimi i pestë (V):* Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit te OE ankues lidhur me analizën e OE "Defence Security" SHPK sqaron se, OE ankuesi ne ankese ka bashkangjitur një dëshmi lidhur me analizën mirëpo tek shujta mendoj se ka ndërhyrje nga 2 euro OE ankues (ju) keni vendosur 1 euro, kurse sa i përket kalkulimit, në analizë shihet tek pika 4. Për festa 7500 euro, mirëpo AK gjatë procesit të rivlerësimit duhet ta sqaroj analizën edhe njëherë, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht e bazuar.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorëve ekonomik ankues OE "Defence Security" SH.P.K, ankesën e OE "Security Code" si dhe ankesën e OE "S.I.G" SHPK. Argumentimi në raportet e ekspertit shqyrtues janë mjaft të detajuar, të kuptueshëm dhe të bazuara tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Defence Security" SH.P.K dhe "S.I.G" SHPK janë të bazuara, ndërsa pretendimet ankimore të OE "Security Code" SHPk janë pjesërisht të bazuara. Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 lidhur me nenin 72 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës duhet të anulohet dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim. Paneli i vlerëson dhe e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues sipas vlerësimit të pavarur të tij vlerëson se pretendimet e OE-ve ankues "Defence Security" "Security Code" dhe "S.I.G" për mos plotësim të kërkesës së dosjes së tenderit nga OE i rekomanduar është i bazuar për faktin se OE i rekomanduar ka bashkangjitur analizën financiare, ku shihet se ka kalkuluar shujtën e punëtorëve me çmimin 1.13 euro, gjersa AK në DT ka kërkuar që shujta mos të jetë më e ulët se 2 euro. AK lidhur me këtë pikë ankimore nuk ka jap asnjë arsyetim në përgjigjet e kërkesave për ri-shqyrtim. Kjo pikë e dosjes së tenderit, më saktësisht mos plotësimi i saj e bën të papërgjegjshëm OE të rekomanduar nga AK për dhënie të kontratës. Rrjedhimisht, paneli shqyrtues në vlerësimin e tij të pavarur konsideron se me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave AK ka veruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Më tej, paneli shqyrtues i vlerëson si të bazuara konstatimet e ekspertit shqyrtues, lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik, dhe sqaron se AK duhet të veprojë konform këtyre konstatimeve/rekomandimeve gjatë rivlerësimit, dhe të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së, sipas këtyre konstatimeve.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën 1 dhe 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën 4 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Në pikën 5 të vendimit është lejuar kthimi i tarifës për OE "Security Code" me nr. 2023/0594, edhe pse është tërhequr nga ankesa pas ekspertizës por sipas kësaj ekspertize ankesa ka qenë pjesërisht e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **DEFENCE SECURITY SH.P.K., Security Code, S.I.G. SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: